



## NJOFTIM SHPALLJE PUBLIKE PËR QIRADHËNIE

Njësia Nr.	Emri i Ndërmarrjes Shoqërore	Emërtimi	Vendndodhja e asetit-pronës (Adresa)	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Qiradhënie e mujore/vjetore
Njësia 1	GJ004 NSH KBI Agrokultura	Një pjesë e parcelave P-70403013-01962-1 me sipërfaqe 174m <sup>2</sup> dhe P-70403013-01963-2 me sipërfaqe 176m <sup>2</sup> (sipas skicës e disponueshme ne ZR GJI)	Zona Kadastrale Gjilan, Komuna e Gjilanit	350m <sup>2</sup> (3ari 50m <sup>2</sup> )	Qiradhënie mujore
Njësia 2	GJI012 NSH Plantacioni	Tokë komerciale ne Ferizaj, ngastra kadastrale 00546-0, Pemishte e klasës I	Zona Kadastrale Ferizaj, Komuna Ferizaj	2429m <sup>2</sup> (24ari 29m <sup>2</sup> )	Qiradhënie mujore
Njësia 3	GJI027 NSH Zhivko vasiq	Toka komerciale në Domorovc, parcela kadastrale P-73507029-001784-0.	Zona Kadastrale Domorovc, Komuna e Ranulluk	339m <sup>2</sup> (3ari 39m <sup>2</sup> )	Qiradhënie mujore
Njësia 4	GJI170 NewCo XIM Strezovci	Një pjesë e objektit administrativ	Zona Kadastrale Berivojcë, Komuna e Kamenicës	200m <sup>2</sup>	Qiradhënie mujore
Njësia 5	GJI170 NewCo XIM Strezovci	Një pjesë e objektit administrativ	Zona Kadastrale Berivojcë, Komuna e Kamenicës	119m <sup>2</sup>	Qiradhënie mujore
Njësia 6	GJI141 KB Globoçica	Aseti ne Qafë shqipe – Toka dhe objekti, parcela kadastrale, P-70917018-00684-4	Fshati Qafëshqipe, Komuna e Kaçanikut	6290m <sup>2</sup> (62ari 90m <sup>2</sup> )	Qiradhënie e mujore
Njësia 7	GJI035 NSH Agromorava	Lokali në Gjylekar, i cili gjendet në ngastrën kadastrale P-70101022-01425-0.	Zona Kadastrale në Gjylekare, Komuna e Vitisë	200m <sup>2</sup>	Qiradhënie mujore
Njësia 8	GJI035 NSH Agromorava	Tokë komerciale në Viti, ngastra Kadastrale P-70101007-02487-11, me kulturë arë klasa e I-rë. <i>*Përrjashohet vetëm objekti i ndërtuar me material të fort.</i>	Zona Kadastrale Viti, Komuna e Vitisë	1030m <sup>2</sup> (10ari 30m <sup>2</sup> )	Qiradhënie mujore

### Kushtet e përgjithshme:

1. Periudha e Qiradhënies është deri në 1 vit me mundësi vazhdimi gjithashtu edhe ndërprerje për shkaqe të privatizimit ose çështjeve tjera relevante. Për shfrytëzim komercial aplikohet qiraja mujore.
2. Ofertat për qiradhëniet komerciale apo mujore duhet të dorëzohen vetëm nga personat juridik apo përfaqësuesit e tyre për secilën njësi veç e veç.
3. Ofertat duhet të dorëzohen personalisht apo në rast që dorëzohen në emër të qiramarrësit pala duhet ta ketë autorizimin e noterizuar tek noteri.
4. Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur (një zarf - një ofertë për një njësi) në Zyrën Rajonale të AKP-së në Pejë.
5. Në zarf (jashtë) duhet të specifikohet: nr. i Njesisë, emri i NSH-së dhe vendndodhja e asetit.
6. Qiramarrësi potencial duhet ta paguaj me një këst shumën që është e barabartë me shumën pagesës së qirasë për një muaj menjëherë pas nënshkrimit të kontratës apo për shfrytëzim bujqësor shumën sezonale/vjetore menjëherë pas nënshkrimit të kontratës;
7. Në rastet e qiradhënies mujore në vlera 300 Euro e më lartë, para nënshkrimit të kontratës do të kërkohet nga ofertuesi fitues të sjellë garancionin financiar me kohëzgjatje për 13 muaj me vlerën e mbulueshmërisë për 6 (gjashtë) qira mujore (vlera totale e 6-shtë qirave mujore).
8. Për dorëzimin e ofertës duhet të përdoret Formulari adekuat për Dorëzim të Ofertës, formulari për qiradhënie mujore (për qiradhënie komerciale), të cilët formularë mund të merren në Divizionin e Zyrës Rajonale të AKP-së, apo të

shkarkohen nga ueb-faqja: [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org). Nëse nuk përdoret forma adekuate e ofertimit, ofertuesi do të diskualifikohet.

9. Kriteri për përzgjedhjen e ofertuesit fitues të njërive përkatëse do të jetë çmimi i ofertës më të lartë.
10. Ofertat do të pranohen në datën **28.04.2026** prej orës **10:00 - 12:00** në zarf të mbyllur për secilën njësi veç e veç.
11. Zarfet do të hapen publikisht në Divizionin e Zyrës Rajonale të AKP-së në Gjilan me datë datën **28.04.2026** nga ora **12:30**.
12. Ofertat përmes faksit nuk do të pranohen.
13. Sipërfaqet e prezantuara më lartë janë të përafërta dhe të dhënat më të sakta me ortofoto mund të merren në Zyrën Rajonale të AKP-së në Gjilan .
14. Të dhënat e detajuara për pronat lëndë e ofertës mund të merren në Divizionin e Zyrës Rajonale të AKP-së në Gjilan, Rruga Mulla Idrizi nr.111, City Project III, Gjilan; në telefonin: +383 280 310 444 apo në e-mail adresën: **info@pak-ks.org**
15. Në çmimin e ofertës totale duhet të përfshihen të gjitha tatimet e aplikueshme në Kosovë, përfshirë edhe TVSH 18%, etj.
16. Ne ato raste kur ekzistojnë dy oferta të njëjta, çështja rregullohet që ofertuesi i parë për nga koha, ka përparësi.

#### **Pagesa e Qiramarrjes:**

Ofertuesit fitues është i obliguar që të paguaj shumat me pagesa të rregullta paraprake mujore, duke filluar me pagesën e parë të caktuar në fillimin e kësaj Kontrate të Qirasë, dhe, deri në masën që është e zbatueshme, me pagesa mujore në vijim, të caktuara në të njëjtën ditë të muajit vijues, (apo më herët në rast se data e pagesës së parë apo ndonjë pagesë tjetër mujore rastis të jetë ndonjë festë publike.

#### **Dispozita të përgjithshme:**

Asetet e listuara të këtyre njërive të paraqitura më lartë ofrohen për dhënie me qira “ashtu siç janë” dhe “ku janë”. Ofertuesit kanë përgjegjësinë të verifikojnë përshkrimin dhe kushtet asetëve (gjendjen faktike) dhe AKP respektivisht Autoriteti i Likuidimit i NSh-ve përkatëse do të konsiderojë se ofertuesit kanë dijeni të mjaftueshme në lidhje me pronat e ofruara për qiradhënie dhe nuk do të jenë përgjegjës për ndonjë pengim të posedimit-shfrytëzimit eventual.

Përderisa këto asete ofrohen për shfrytëzim komercial/industrial, atëherë Autoriteti i Likuidimit njofton të gjithë qiramarrësit potencial se në rast se të njëjtit nuk do të mund të ushtrojnë veprimtaritë e planifikuara për shkak të mos pajisjes me leje komunale apo për shkak të kufizimeve tjera ligjore, Autoriteti i Likuidimit nuk do ju njuh të drejtën në kompensim apo lirimin nga qiraja mujore, andaj është përgjegjësi e secilit qiramarrës potencial që brenda afateve të arsyeshme të hulumtojnë dhe kryen verifikimet e duhura pranë institucioneve relevante, nëse veprimtaritë komerciale/industriale mund të kryhen në këto hapësira.

#### **Ofertuesit me ndalesë ofertimi:**

- Personat fizik apo juridik të cilët kanë uzurpuar paluajtshmërinë në pronësi shoqërore të cilët kanë refuzuar për të hyrë në marrdhënie kontraktuale të qirasë dhe të paguajnë për periudhën retroaktive të shfrytëzimit, ndaj të cilëve Agjencia apo NSh -ja ka iniciuar procedurë gjyqësore për lirimin e pronës dhe kompensimin e dëmeve eventuale;
- Personat fizik dhe juridik që: (i) nuk i kanë respektuar kushtet e ndonjë kontrate të lidhur me Agjencinë ose me çfarëdo ndërmarrje që administrohet nga Agjencia (ekzistenca dhe natyra e atij mosrespektimi do të përcaktohet nga Agjencia sipas zgjedhjes së saj), (ii) kanë borxh ose gjobë të pashlyer ndaj Agjencisë ose ndonjë ndërmarrje që administrohet nga Agjencia, (iii) personat fizik ose juridik të cilët nuk kanë paguar gjobat e caktuara nga Agjencia ose që i nënshtrohen ndonjë kërkesëpadie ose kontesti (pa marrë parasysh nëse çështja e tillë është ngritur në gjykatë apo tjetërkund).

**Ofertat do të pranohen në datën 28.04.2026 prej orës 10:00 - 12:00  
në zarf të mbyllur për secilën njësi veç e veç në:**

**Divizioni i Zyrës Rajonale të AKP-së në Gjilan**

**Tel: 0280/310-444**

**Adresa: Rr. Mulla Idrizi nr. 111, City Project III, 60000 Gjilan**

**e-mail: [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org); [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)**